



Ndal Punës së Fëmijëve

Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve  
nëpërmjet edukimit,  
artit dhe medias

Informacioni bazë



**Objektivi:** Sigurimi i të dhënave kryesore në lidhje me punën e fëmijëve, si dhe të informacionit të nevojshëm për të kuptuar tërësinë e problematikës që ngërthen kjo dukuri.



**Përfundimi:** Nxitja e interesit dhe të kuriozitetit të të rinjve, si dhe nxitja e një gjendjeje të caktuar emocionale, falë përdorimit të fotografive, figurave, të dhënave statistikore dhe informacionit rreth punës së fëmijëve në mjedise të ndryshme.

## Koha

*Një orë mësimi e ndarë në dy pjesë ose dy orë mësimi*

## Motivimi

Sipas Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO)<sup>1</sup>, në botë ka 245,5 milionë fëmijë nën moshën 18 vjeç që punojnë. Nga këta, rreth 180 milionë fëmijë punojnë në kushtet më të këqija të mundshme.



Në Arfikën Subsahariane, në Azi dhe në rajonin e Paqësorit fëmijët që punojnë, përbëjnë më shumë se 83% të dukurisë botërore të shfrytëzimit të punës së fëmijëve të moshës 5-14 vjeç. Për shkak të punës që kryejnë, këta fëmijë janë të privuar nga arsimimi, si dhe janë viktimat e dhunës fizike, seksuale dhe psikologjike. Disa prej tyre bëhen me aftësi të kufizuara, të tjerë vdesin para se të arrijnë moshën e rritur, fëmijë të tjerë mbartin edhe probleme psikologjike për gjithë jetën.

<sup>1</sup> Burimi:

"A future without child labour", raporti botëror i hartuar në vijim të Deklaratës së ILO-s mbi Parimet dhe të Drejtat Themelore në Punë, ILO, 2002



Për shumë njerëz puna e fëmijëve është e padukshme. Ajo është e tillë pasi fëmijët rekrutohen dhe punësohen në sektorë të tillë që shoqëria parapëlqen të bëjë sikur nuk e di. ILO po bën përpjekje të mëdha për të mënjanuar përmasën e vertetë që ka dukuria e punës së fëmijëve në të gjithë botën. Gjithësesi, vlerësim real i shtrirjes së kësaj dukurie kërkon kohë, studim dhe kërkim, veçanërisht për ato lloje punësh që vënë në rrezik jetën e fëmijëve, si, p.sh., prostitucioni i fëmijëve, fëmijët ushtarë apo pëfshirja e fëmijëve në punët e shtëpisë. Të bësh të dukshme punën e fëmijëve, kjo është rruga për të shembur murin e indiferencës që ka ngritur shoqëria kundrejt kësaj plage. Të bësh të dukshme punën e fëmijëve, ky është dhe objektivi i moduleve.

Dy janë komponentët kryesorë të fushatës për mënjanimin e plotë të punës së fëmijëve: përfshirja e fëmijëve në arsim dhe ulja e varfërisë. Në vitin 2000, 13% e fëmijëve të moshës 10-14 vjeç punonin, në vend që të shkonin në shkollë. Është provuar se më shumë arsim për fëmijët e ul çdo vit në mënyrë të ndjeshme mundësinë e shfrytëzimit të tyre ekonomik. Arsimimi është një e drejtë e fëmijëve, por ai duhet të jepet falas dhe me cilësi, përndryshe është i paarritshëm dhe i papërshtatshëm pikërisht për ato shtresa të popullsisë që kanë më shumë nevojë.



Ky modul jep informacionin bazë, si dhe të dhëna thelbësore që do t'i shërbejnë mësuesit dhe edukatorit që

## Shënim për përdoruesin


Është e këshillueshme të përdoret në fillim ky modul, por mund të realizohet edhe së bashku me modulën "Kolazh". Të dyja këto module plotësojnë njëri-tjetrin deri në kohën kur të rinjtë kanë një ide të qartë për punën e fëmijëve. Nga ana tjetër, këto module të japin një bazë të fuqishme për zhvillimin e moduleve të tjera edhe pse jo të të gjithave.

Nëse do të vendosni të veproni në këtë mënyrë, ju këshillojmë të realizoni më pas modulën e kërkimit dhe të informacioni, e cili i nxit të rinjtë që të kërkojnë vetë informacion më të zgjeruar për punën e fëmijëve. Në këtë modul jepen statistikë më të rëndësishme që përdoren nga organizatat, nga qeveritë dhe nga mjetet e informimit, gjë që shërben për të shmangur punën përgatitore të mëtejshme, si dhe për të mbajtur të gjallë interesin për të mësuar më shumë për një temë.

“të parapërgatisin situatën” për grupin e të rinjve, me të cilët do të zhvillohet. Gjatë paraqitjes së shifrave duhet t’u bëhet e ditur të rinjve se ato janë të bazuara në të gjitha burimet e mundshme të informacionit. Por s’mjafon me kaq, duhet bërë më tepër për të zbuluar fytyrën e vërtetë të punës së fëmijëve. Ideja e modulit është që në grup të krijohet një atmosferë dhe ndërgjegjësim i caktuar që do të përbëjë platformën nga ku do të zërë fill projekti.

## Përgatitja

Ky modul nuk kërkon shumë punë përgatitore, pasi i gjithë informacioni i është bashkëngjitur. Qëllimi i veprimtarisë është të nxisë diskutimin e përgjithshëm në gjirin e të rinjve dhe ta mbajë gjallë interesin dhe fymën e dëbatit ndërmjet tyre. E gjithë kjo realizohet nga informacioni që është në modul, nga i cili marrin shkas dhe



## Shënim për përdoruesin

Nëse keni mundësi të lidheni me selinë e IPEC-it në Gjenevë, ju këshillojmë t’i kërkonti videon (e gjatë 10 minuta) *Combating Child Labour: the Global Cause* (Lufta kundër punës së fëmijëve është një çështje botërore). Kjo video është një mjet efektiv vizual që paraqet punën e fëmijëve. Krahas informacionit që jep për IPEC-un, ajo paraqet gjithashtu, punën e fëmijëve në kushte të rrezikshme. Mesazhi që përcjell videoja, është shumë i vështirë për t’u harruar.

Video që tregojnë për shfrytëzimin dhe skllavërimin e fëmijëve në punë, kanë prodhuar dhe organizata të tjera. Ju këshillojmë të lidheni me selitë e tyre për të marrë në formë huaje materiale që ju duhen. Gjithashtu, ka edhe institucione shtetërore, ministri të ndryshme (në Ministrinë e Punës dhe të Çështjeve Sociale është njësi që shërben në kuadër të projektit që ka IPEC-u me vendin tonë, ku mund të drejtoheni për materiale).

Është e këshillueshme të lexoni të dhënat statistikore para se të futeni në klasë. Njohja paraprake e tyre është e dobishme, pasi, mbi këtë bazë, mund të përcaktoni temën qendrore, mbi të cilën do të zhvillohet diskutimi.

pyetjet që ngrenë të rinjtë gjatë debatit. Kjo veprimtari e parë do të shërbejë për orientimin e projektit. Nga ana tjetër, është e rëndësishme të informoni grupin se veprimtaria mund të jetë paksa e veçantë në krahasim me veprimtaritë që do të zhvillohen më pas.

## Çfarë ju duhet



- ✓ Për realizimin e modulit nuk ju duhen shumë materiale, pasi qëllimi i tij është të nxisë diskutimin në grup për punën e fëmijëve.
- ✓ Informacioni statistikor i bashkëngjitur;
- ✓ Dërrasë e zezë ose tabak letre e bardhë;
- ✓ Letër, lapsa ose stilolapsa për t'u krijuar pjesëtarëve të grupit kushte të mbajnë shënime;
- ✓ Televizor, videoregjistrator dhe, nëse i keni, materialet në video.
- ✓ Katalogu i botuar i IPEC-ut, në CD-ROM, që u është bashkëngjitur moduleve, përmban shumë fotografi për punën e fëmijëve.
- ✓ Çdolloj fotografie dhe figura që keni mundur të gjeni në lidhje me punën e fëmijëve.

## Realizimi i projektit



Uleni grupin në rreth ose në gjysmërreth. Nëse klasa ka banka, të cilat i ndajnë nxënësit ndërmjet tyre, shmangeni këtë pengesë. Zhvendosni të gjitha banka në një anë të klasës dhe ftojini pjesëtarët e grupit të ulen përreth jush në karrike. Jo rrallë vetëvendosja është motiv mobilizimi, kënaqësie dhe interesi për të marrë pjesë. Bëhet fjalë për të marrë pjesë në diskutim, ku mënyra më e mirë është ta shohësh njëri-tjetrin në sy dhe të lëvizësh lehtësisht, pa zhvendosur karrike ose banka.

Merrni pjesë aktive në përcaktimin e vendeve. Përvoja ka treguar se vendosja e rastësishme e pjesëtarëve të

grupit bën jo rrallë që pjesëtarët e tij të grupohen sipas gjinisë. Kjo nuk është e këshillueshme. Nga ana tjetër, ata që janë shokë, do të përpiqen të ulen afër me njëri-tjetrin. Meqë ky projekt është sfidues dhe synon të ndryshojë gjërat, është e rëndësishme të këmbëngulet në uljen e pjesëtarëve të grupit në forma të caktuara, si, p.sh., një djalë-një vajzë përgjatë rrethit. Ose përpiquni t'i ndani nëngrupet e pjesëtarëve që duan të qëndrojnë bashkë. Nuk bëhet fjalë për të krijuar një klimë pakënaqësie, por, nga e kundërta, është një përpjekje për të krijuar që në fillim një frymë miqësie dhe mirëkuptimi në grup.

### Organizimi i grupit



## Veprimtaria 1

### Ç'është puna e fëmijëve

*1 orë mësimi ose gjysma e një sesioni dyorësh*

Fillojeni bisedën me pyetjen “Ç’ju sjell në mend termi “Puna e fëmijëve” dhe ç’do të thotë kjo për ju?”. Nxitini pjesëmarrësit të shprehin atë që dinë për punën e fëmijëve, ç’kanë dëgjuar nga të tjerët, nga televizioni, radioja, ç’kanë lexuar në gazeta apo ç’dinë nga përvoja vetjake. Në fillim të projektit, qëllimi është të njihni se ç’di grupi për punën e fëmijëve. Shënoni në dërrasën e zezë informacionin e rëndësishëm që merrni.

Nëse shikoni që debati nuk fillon, nxiteni duke bërë disa pyetje, si:

- Kur bëhet fjalë për punën e fëmijëve, në ç’moshë mendoni se janë ata?
- Mendoni se bëhet fjalë për vetëm për punën e djemve, të vajzave apo të të dyja palëve?
- Për çfarë pune bëhet fjalë?
- Në cilat pjesë të botës, në cilat vende apo rajone mendoni se ekziston puna e fëmijëve?
- Sipas mendimit tuaj, a shpërblehen fëmijët për punën që kryejnë?





## Shënim për përdoruesin

Diskutimi paraprak nuk duhet të jetë shterues. Në fazat e mëtejshme do të keni mundësi të thelloheni në diskutim. Madje, mund të vendosni të mos përdorni të gjithë materialin që keni në këtë modul. Informacioni që ekziston, është më se i mjaftueshëm dhe ju mund të zgjidhni atë që është më i përshtatshëm për grupin tuaj. Nuk bëhet fjalë për një garë ku secili të shpalosë sa më shumë informacion, por bëhet fjalë për një metodë dinamike për të trajtuar problemin.

- A trajtohen mirë fëmijët?
- Fëmijët që punojnë, a jetojnë në shtëpitë e tyre?
- A shkojnë ata në shkollë?

Bëhet fjalë për të hedhur në diskutim problemin dhe grupi të vlerësojë njohjen dhe të mbajë qëndrim rreth tij.

Pas përfundimit të diskutimit, nëse keni ndonjë material filmik në lidhje me problemin, mund ta shfaqni. Gjatë shfaqjes së videos, vendosuni anash në mënyrë që të vëzhgoni ndikimin dhe reagimin e secilit pjesëmarrës të grupit ndaj materialit të videos.

Nëse puna e fëmijëve është një problem i madh për vendin ose nëse ka në grup fëmijë që kanë punuar, diskutimi do të jetë me të vertetë i larmishëm. Nëse pjesëtarët e grupit kanë njohuri të afërta për punën e fëmijëve, përpiquni ta thelloni diskutimin në këtë plan. Mbani shënim në dërrasë të zezë të gjitha çështjet themelore që dalin gjatë diskutimit. Pasi të keni nxitur diskutimi, vazhdoni të pyesni se çfarë dinë për punën e fëmijëve në vende të tjera dhe në botë. Për të mbajtur gjallë diskutimin, ripërsëri në këtë rast pyetje që ju rreshtuam më lartë. Në këtë moment, grupi do të kalojë nga përgjigje për të cilat ndiehet i sigurtë, në përgjigje të tjera, për të cilat nuk ka menduar më parë, p.sh., që në vende të tjera të botës mund të ketë fëmijë në kushte të tilla ose më të këqija.

Shtesat e këtij moduli përmbajnë një listë me të dhëna statistikore bazë për punën e fëmijëve. Këto mund të përdoren për të gjallëruar diskutimin. Nëse vëreni se trajtimi i një çështjeje po shteron, orientojeni diskutimin në një drejtim tjetër duke pyetur: "Në ç'moshë fillojnë të punojnë fëmijët në shtëpi?". Ndoshta diskutimi mund të vazhdojë në këtë drejtim, madje duke përdorur dhe të dhënat statistikore. P.sh., mund të përdorni të dhënat për numrin e fëmijëve në Indonezi që punojnë nëpër shtëpi, për orët që punojnë, ç'lloj dhune i nënshtrohen etj. Nëse të dhënat statistikore përdoren me kujdes, ato jo thjesht të paraqiten, por të diskutohet për to. Përvoja



ka treguar se frytshmëria e përdorimit të tyre është e ndjeshme. Funkzioni i tyre është pikërisht të mbajë gjallë diskutimin në grup.

Mos u përpiqnin të përdorni të gjithë informacionin statistikor, lista bashkëngjitur është e gjatë, zgjidhni ato shifra që ju mendoni se janë të rëndësishme për mjedisin tuaj. Paraqitja e informacionit të shumtë rrezikon pështjellimin e grupit, i cili nuk do të jetë në gjendje të vlerësojë këtë informacion. Është me vend të përdorni të dhëna të thjeshta në sasi të kufizuar.

## Veprimtaria 2

### Shkaqet dhe rrjedhojat e punës së fëmijëve

*Koha*

*30 – 35 minuta*

Pas diskutimit dhe mbi bazën e çështjeve themelore që janë trajtuar dhe parapëlqimit të grupit, vendosni të kaloni ose jo në trajtimin e temave më specifike. Përpiquni të kuptoni atmosferën që mbizotëron në grup, humorin e pjesëmarrësve dhe, në veçanti, bëni përpjekje që diskutimi të mos i lodhë fëmijët. Ata duhet të përfshihen natyrshëm në diskutim dhe të jenë të motivuar. Vetëm kështu mund të vazhdoni.

Temat që ju kanë dalë gjatë diskutimit, mund të rimerren në faza të tjera të projektit.

Shtesa 2 përmban informacion bazë për punën e fëmijëve që do t'ju ndihmojë të zhvilloni diskutimin. Me kalimin e kohës bëni kujdes dhe konsultohuni me informacionin e shtesës 2 në mënyrë që tematikat e tyre më të rëndësishme të gjejnë trajtim. Përballini të dhënat e shtesës me ngjarje të treguara nga fëmijët e grupit. Gjithashtu, propozoji grupit të ballafaqojë informacionin duke u ndalur në arsyet e pranisë së kësaj dukurie, duke kërkuar se ç'mund të bëhet për të zgjidhur problemin.



**Çështje për diskutim****Pse ekziston puna e fëmijëve?**

Kjo pyetje hap diskutimin përse puna e fëmijëve është një dukuri botërore. Për të rinjtë, pyetja “Përse?” është gjithmonë një pikënisje për debat. Në rastin tonë për punën e fëmijëve mund të jetë një çështje interesante, veçanërisht nëse kjo dukuri nuk është shumë e përhapur në vendin tuaj. Por edhe në të kundërtën, nëse puna e fëmijëve është e përhapur. Në këtë rast, do të jetë interesante të dëgjosh se çfarë thonë të rinjtë në lidhje me arsyet pranisë së punës të fëmijëve edhe në rastin kur ata punojnë vetë, edhe në rastin kur flasin për bashkëmoshatarët që punojnë. Nëse të rinjtë e grupit tuaj punojnë, kjo do të ishte një pikënisje tjetër për vazhdimin e diskutimit. Pyetini se ç’ pune bëjnë; sa orë punojnë; sa fitojnë; ç’mendime kanë për punën; përse dhe ç’i ka shtyrë të punojnë; a janë këto të njëjtat arsye si për fëmijët që punojnë ose jo; në rast se jo, ku qëndron dallimi etj.

**Pse “kërkohen” fëmijët si punëtorë?**

Puna e fëmijëve ekziston, pasi shumë punëdhënës kërkojnë të punësojnë pikërisht fëmijët dhe jo të rriturit. Pyesni grupin nëse e di këtë gjë dhe pse ndodh kështu; pse një i rritur që është i përgjegjshëm, i nxit fëmijët të punojnë për të; cilat janë motivet që e shtyjnë të punësojë një fëmijë etj. Pyeteni grupin nëse punëdhënësi kur punëson një fëmijë, a i mban parasysht rreziqet me të cilat përballet fëmija, nëse e shikojnë fëmijën si një person të ndryshëm nga punëtorët e tjerë, nëse e dinë se është e drejtë e fëmijës të arsimohet falas dhe nëse është i ndërgjegjshëm për dëmin që u sjell fëmijëve.

Zakonisht këto çështje ngjallin diskutime interesante dhe me vlerë. Ndoshta, pikërisht këta punëdhënës, në kohën e tyre kur kanë qenë fëmijë, kanë punuar dhe nuk arrijnë të kuptojnë se puna për atë moshë është e dëmshme. Në këtë moment, në varësi të kushteve, traditës dhe kulturës së shoqërisë, trajtohen çështjet e mësipërme dhe për rrjedhojë ceket dhe problemi filozofik nëse është e drejtë apo e gabuar puna e fëmijëve.

Megjithatë, mundet që disa punëdhënës të shtyrë vetem nga fitimi nuk shqetësohen për pasojat e punës së fëmijëve. Si mund të luftohet kjo mënyrë të menduari?

## A është puna e fëmijëve diçka e keqe?

Disa nga pjesëtarët e grupit mund të mendojnë se puna e fëmijëve nuk është një dukuri kaq negative. Ata mendojnë se puna është e nevojshme, pasi shumë prej tyre së bashku me familjet do të vdisnin nga uria, nëse nuk do të punonin. Hapni diskutimin në grup për mënjanimin e plotë të punës së fëmijëve dhe për të drejtën e tyre të jetojnë fëmijërinë e vet, të arsimohen, të luajnë dhe të duhen nga familja.

## Puna e fëmijëve, si i dëmton ata?

Gjatë diskutimit të kësaj teme, ju jepet mundësia të nxirrni në pah se puna e fëmijëve, veçanërisht në kushte të rrezikshme, është e dëmshme për fëmijët. Edhe pse në grupin tuaj mund të ketë fëmijë që punojnë, është e rëndësishme që ata të ndërgjegjësohen për rreziqet e mundshme që kanë disa lloje punësh, si dhe arsyet pse duhet të mbrohen fëmijët. Ndonjëherë, fëmijët mendojnë se janë “të pamposhtur”, veçanërisht në vendet e industrializuara. Mendojnë se asgjë nuk i dëmton dhe se nuk përbën ndonjë problem puna që bëjnë. Në këto raste kur nuk janë në gjendje të kuptojnë rrezikshmërinë afatshkurtër dhe afatgjatë të punës së tyre, ata bëhen armiq të më të këqinj të vetvetes.

Në shtesën 2 do të gjeni informacionin e detajuar për dëmin që kanë lloje të ndryshme pune për fëmijët. Hapni përsëri diskutimin me grupin, duke i kërkuar mendimin si mund të dëmtojë puna zhvillimin fizik dhe psikologjik të fëmijëve. Në shtesën 3, jepen dëmtimet që u sjellin fëmijëve disa nga format më të këqija të punës. Parashtoni shembuj të disa lloj punësh dhe pasoja negative që kanë ato në shëndetin e fëmijëve. Gjatë diskutimit shënoni në dërrasën e zezë të gjitha mendimet dhe komentet që bëhen. Do të shikoni se me kalimin e kohës pjesëtarët e grupit gjatë diskutimit do të ndërgjegjësohen për pasojat e punës së fëmijëve.



## Shënim për përdoruesin

Në varësi të kohës dhe mjedisit që keni në dispozicion, fëmijët mund t'i ndani në grupe më të vogla për të diskutuar më gjërë dhe me thellë për problemin. Secilit grup mund t'i jepni apo sugjeroni një temë për diskutim. Në përfundim të tij, të gjitha grupet do të raportojnë. Në këtë mënyrë të gjithë do të përfitojnë nga diskutimet e të gjitha grupeve.

## Ç'duhet bërë dhe ç'duhet shmanguar



- Diskutimi të orientohet nga një frymë pranuese. Gjithçka që thuhet, madje edhe nga një pjesëtar i vetëm i grupit, duhet të dëgjohej me vëmendje.
- Të gjithë duhet të marrin pjesë në diskutim. Nëse ndonjëri është i tërhequr, nxiteni të shprehë dhe ai mendimin e vet apo të bëj ndonjë koment.
- Shoqërojeni diskutimin me gjeste miratuese dhe komentoni gjallërisht ato që thuhën.
- Për të mbështetur debatin dhe diskutimin me të dhëna statistikore, përdorni informacionin që ju është dhënë në shtesat e modulit.
- Diskutimi nuk duhet të zgjatet shumë. Mundohuni të siguronit një pjesëmarrje të përgjithshme në diskutim. Nëse bie ritmi dhe entuziasmi, mbylleni diskutimin në çastin e duhur. Është e rëndësishme që grupi të mos mërzhitet. Mbajeni të hapur diskutimin, nëse në të përfshihet pjesa më e madhe e grupit dhe mos e lejoni që të vazhdojë vetëm për një ose dy pjesëtarë që tregohen të interesuar. Mund t'i riktheheni kësaj çështjeje në një moment më të përshtatshëm.
- Mundohuni të siguronit që pjesëtarët e grupit jo vetëm të marrin pjesë në diskutim, por dhe ta udhëheqin atë. Nëse vlerësoni se një pjesëtar është shumë i interesuar për problemin, nxiteni ta udhëheqë atë në vendin tuaj. Një ndër qëllimet e moduleve është ta bëjë grupin të përgjegjshëm dhe t'i ndihmojë të rinjtë të krijojnë besim në vetvete. Pra është e këshillueshme të zhvilloni besimin e të rinjve tek vetja në lidhje të ngushtë me respektimin e mendimit të të tjerëve.
- Elemente të tjera që duhen lejuar gjatë diskutimit janë: përdorimi i shakasë, ironisë, i elementeve të garës, por të gjitha këto në atë masë që ju mund t'i mbani nën kontroll.
- Mos krijoni tension dhe mos i vini pjesëtarët e grupit në pozitë të vështirë që mund të kompromentojë krijimin e klimës së vetëbesimit. Nëse njëri prej tyre nuk është gati të marrë pjesë në diskutim, ose nuk ka ndonjë gjë për të thënë, respektojeni dhe kaloni te dikush tjetër që dëshiron të flasë.
- Pjesëtarët e vendosin vetë se kur është momenti të ndërhyjnë. Veçanërisht në fazën e parë të modulit, disa kanë nevojë për më shumë kohë se të tjerët.

## Diskutimi përfundimtar

*10 – 15 minuta*

Para se të përfundojë moduli, mblidhni të gjithë të diskutojnë lirshëm. Si përvojë e parë, ndoshta pjesëmarrja në të, për disa, ka qenë disi e vështirë. Nga ana tjetër, ata janë përballur me një informacion të shumtë dhe jo rrallë herë i vështirë për t'u pranuar edhe nga të rriturit. Puna e fëmijëve është me të vertetë një nga format më të egra të shfrytëzimit të më të dobtëve, e cila mund të shkaktojë trauma të rënda, vonesë në zhvillimin mendor, madje dhe vdekje. Bëhet fjalë për një realitet, në të cilën ndodhen me miliona fëmijë në botë.




Tashmë, grupi ka ide më të qarta dhe më të thella për dukurinë e punës së fëmijëve dhe arsyet që e shkaktojnë. Pa dyshim që ju nuk jeni thelluar në të gjitha aspektet e dukurisë, por gjithësesi ju keni filluar të zbuloni disa nga të fshehtat që ndihmojnë të largojnë mjegullën që fsheh punën e fëmijëve.

Trajtimi i disa problemeve ka qenë i vështirë, veçanërisht me adoleshentët, të cilët, për problemet që kanë në këtë periudhë të jetës së tyre, janë të mbyllur. Ja pse është shumë e rëndësishme që këto diskutimi të udhëhiqen me takt, durim dhe vëmendje. Mënjanoni shkurajimin e pjesëtarëve të grupit për të marrë pjesë në diskutim, pasi kjo do të vinte në dyshim pjesëmarrjen e tyre në veprimtaritë e tjera. Shfrytëzoheni diskutimin përfundimtar për t'u dhënë mundësi të rinjve të shprehen sa më hapur që të jetë e mundshme. Nëse nuk dëshirojnë të flasin për punën e fëmijëve, jepuni mundësinë të flasin për atë që duan, por që lidhet me temën. Kjo mënyrë është po aq e rëndësishme pasi ju jep mundësi të gjykoni rreth mënyrës si i ndiejnë dhe i trajtojnë problemet pas diskutimit në grup. Lejoni që gjërat të ndjekin rrjedhën e vet, pa ndërhyrë. Ndonjëherë është më mirë të ngushtoni kontrollin e grupit për t'i lënë të rinjtë të shprehen për të përcaktuar se cili është argumenti kryesorë që u intereson.

Nga ana tjetër, t'u lësh të rinjve një farë lirie, do t'ju ndihmojë të krijoni besimin e duhur në grup. Është shumë e rëndësishme që të rinjtë të ndjehen të lirë të shprehen në grup dhe përballë jush. Ata duhet të perceptojnë qartë se ju i dëgjoni dhe i vlerësoni për atë që thonë. Kjo përbën bazën mbi të cilën do të ndërtohet përgjegjshmëria e grupit gjatë zhvillimit të projektit.

Veçanërisht theksoni se e gjithë kjo bëhet në emër të shpresës se gjërat duhet dhe mund të ndryshojnë. Puna e fëmijëve mund të mënjanohet. Ky nuk është një objekt i paarrtishëm



## Vlerësimi dhe vazhdimi

Ky modul nuk ka kritere të përcaktuara për t'u vlerësuar. Objektivi i tij është t'i hapë rrugën realizimit të projektit dhe të nxisë interesin për dukurinë e punës së fëmijëve. Ajo që duhet të arrihet, është mbajtja e qëndrimit, shprehja e emocioneve dhe ndjenjave, si dhe të kuptuarit e problemit.

Punën e kryer ju duhet ta vlerësoni mbi bazën e nivelit të vëmendjes dhe të përfshirjes në diskutim që ka treguar grupi. Duhet të jeni të ndërgjegjshëm me veten dhe të vlerësoni drejt këto aspekte. Diskutimi mund të ketë qenë shumë interesant dhe argëtues për grupin.

Ky modul përbën një mjet të thjeshtë, por i frytshëm për t'u hapur sytë të rinjve për dukurinë e punës së fëmijëve, pavarësisht se ekziston ose jo në vendin tuaj. Mësimi që duhet të marrin të rinjtë nga ky modul, është shumë i rëndësishëm për të kuptuar sa e tmerrshme është puna e fëmijëve dhe çfarë pasojash të rënda ka për ta. Nga ana tjetër, moduli duhet të nxisë dëshirën e të rinjve për të mësuar më shumë dhe për të bërë diçka, çdo lloj gjëje të mundshme, për të dhënë ndihmesë në mënjanimin e plotë të punës së fëmijëve.

Gjithashtu, ku modul do t'i njohë nxënësit me nivelin e shfrytëzimit të punës së fëmijëve në botë si në vendet e industrializuara, ashtu dhe në vendet në zhvillim. Motivi kryesor që mban gjallë punën e fëmijëve në shekuj, është se për shumë kohë kjo punë është fshehur me shpresë që nuk do të zbulohet kurrë. Për rrjedhojë, qeveritë, punëdhënësit dhe shoqëria, në tërësi, nuk janë marrë kurrë seriozisht me këtë dukuri. Tani situata po ndryshon, me ngadalë, por pa pushim. Sa më shumë njerëz të njihen me problemin dhe të protestojnë, aq më e madhe do të të jetë trysnia që do të ushtrohet për t'u bërë diçka.

Pasi të keni përfunduar këtë modul, mund të kaloni në zhvillimin e një moduli tjetër. Ju këshillojmë të realizoni modulën "Kolazhi", që përmban veprimtari argëtuese dhe emocionalisht më të lehta për t'u përballuar.



## Shtesa 1

- Në botë ka 245,5 milionë fëmijë që punojnë nën moshën 18 vjeç. Nga këta, 186 milionë janë në moshën 5-14 vjeç dhe më shumë se 59 milionë janë 15-17 vjeç.
- Afërsisht 170 milionë fëmijë punojnë në kushte të rrezikshme. Nga këta, 111 milionë janë në moshën 5-14 vjeç dhe më shumë se 59 milionë janë në moshën 15-17 vjeç.
- Rreth 180 milionë fëmijët punojnë në kushtet më të këqija.
- Gjithashtu, të dhënat tregojnë se më shumë se 8 milionë fëmijë i nënshtrohen formave më të këqija të shfrytëzimit në punë. Nga këta, 6 milionë i nënshtrohen punëve të detyruara, 0,3 milionë janë fëmijë ushtarë, rreth 2 milionë përdorën në tregun e prostituimit dhe të pornografisë, rreth 0,5 milionë janë përfshirë në veprimtari ilegale.
- Më shumë se 1,2 milionë fëmijë përfshihen në trafiket ilegale.
- Vlerësohet që numri i fëmijëve aktivë në ekonomi është rreth 352 milionë, në moshën 5-17 vjeç.
- Mesatarisht 1 në 6 fëmijë, në moshën 5-17 vjeç, mund të klasifikohet si fëmijë punëtor.
- Rreth 60 % e 211 milionë fëmijëve (më shumë se 127 milionë fëmijë) punojnë në Azi dhe në Paqësor.
- 23 % e tyre punon në Afrikën Subsahariane ose rreth 48 milionë.
- Në Afrikën e Veriut dhe në Lindjen e Mesme punojnë rreth 6 % e fëmijëve ose 13,4 milionë.
- 1,8 % e fëmijëve ose 17,4 milionë fëmijë punojnë në Amerikën Latine dhe në Karaibe.
- Afrika Subsahariane ka përqindjen më të madhe të fëmijëve që punojnë, në raport me numrin e tyre.
- Pjesa më e madhe e fëmijëve të zonës rurale është e përfshirë në punët e bujqësisë.
- Fëmijë të moshës 8-9 vjeç, në Afrikë, punojnë në galeri në 30 metra thellësi nëntokë për 7-8 orë në ditë, gërmojnë në galeri shumë të ngushta, pa sistem ajërimi, pa ndriçimin e nevojshëm dhe në rrezik të vazhdueshëm të shembje së galerisë.
- Në minierat e arit, në Peru punojnë fëmijë të moshës 6 vjeç, në kushte shumë të vështira, për shumë orë, pa asnjë mbrojtje ndaj aksidenteve dhe sëmundjeve. Aksidentet janë të shumta dhe fëmijët preken nga sëmundje të rrugëve të frymëmarrjes.



- Fëmijët punojnë për shumë orë në ditë në punë të rënda.
  - Punët shtëpiake përbëjnë një nga llojet e punës më të përhapura për fëmijët. Kjo punë është shumë e përhapur për vajzat, pasi në kulturën e shumë vendeve, punët e shtëpisë vlerësohen si pjesë e rëndësishme e edukimit të tyre.
  - Familjet e zonave urbane rekrutojnë fëmijë nga zonat rurale, nëpërmjet prindërve, miqve etj., për t'i punësuar në shtëpitë e tyre. Pjesa më e madhe e fëmijëve vijnë nga familje shumë të varfra ose janë fëmijë të braktisur, fëmijë jetim me një prind.
  - Në shumë raste, veçanërisht në rastin e fëmijëve të braktisur ose jetimë, fëmijët që kryejnë punë shtëpie janë tërësisht të varur nga familja që i punëson. Jo rrallë gjendja e tyre është si e një skillavi. Këta fëmijë tregojnë se hanë mbeturinat e të zotëve të shtëpisë, paguhen me një pagë qesharake ose nuk paguhen fare, flenë në dysheme, janë viktima të dhunës fizike ose seksuale dhe janë të izoluar nga të afërmit e tyre. Shumë rrallë shkojnë në shkollë ose luajnë me fëmijët.
  - Pjesa më e madhe e fëmijëve që punojnë në shtëpira, janë të moshës 12-17 vjeç, por disa sondazhe kanë treguar se ka edhe fëmijë të moshës 5-6 vjeç të punësuar në shtëpitë e padronëve.
  - Koha e punës për fëmijët që punojnë në punërat e shtëpisë shkon deri më 15-16 orë në ditë.
  - Vlerësohet se numri i fëmijëve nën moshën 18 vjeç, të detyruar të futen në ushtri dhe të punojnë si korierë, kuzhinierë ose skllavër të seksit, është rreth 300 000, nga të cilët 120 000 janë në Afrikë. Sipas informacionit, moshja mesatare e tyre është 8 vjeç.
  - Në zonat rurale numri i fëmijëve të regjistruar që punojnë, është më i madh se në zonat urbane, por mendohet se në vendet afrikane ky raport do të ndryshojë falë procesit të shpejtë të urbanizimit që është në proces.
  - Pjesa më e madhe e fëmijëve që punojnë në punëra shtëpiake, veçanërisht në zonat rurale, nuk paguhet. Ata që paguhen, marrin një shpërblim shumë herë më të vogël se paga normale, madje kjo e fundit ndryshon në funksion të moshës dhe gjinisë. P.sh., vajzat paguhen shumë më pak se djemtë.
- Shumë fëmijë punojnë në mbrëmje dhe natën. Vajzat e punësuar në punët shtëpiake, jo rrallë flejnë në familjet ku janë të punësuar dhe mund të jenë viktima të dhunës, përfshirë dhe dhunën seksuale.
- Jo rrallë fëmijët shiten. Kjo është një formë skllavërimit që ende ekziston.
- Pronarët e tokave blejnë fëmijët e prindërve që punojnë në tokat e tyre ose, e thënë ndryshe, parapaguajnë punën që fëmijët do të kryejnë në sektorë të ndryshëm: në bujqësi, punë shtëpiake, tregtinë e seksit, industrinë tekstile dhe të qylymave, në miniera, në prodhimin e tullave. Kjo praktikë e punësimit të fëmijëve njihet prej kohësh dhe është e përhapur në Azinë Juglindore dhe në Afrikën Perëndimore. Edhe pse zyrtarisht mohohet ekzistenca e kësaj punë, kjo është shumë e përhapur dhe e dokumentuar.

- Një formë tjetër shumë e përhapur e punës së fëmijëve është puna e fëmijëve për të shlyer borxhin apo ndonjë detyrim tjetër të familjes. Ata që japin borzhe (kryesisht pronarë tokash), manipulojnë dhe situatën në mënyrë të tillë që borxhi pothuajse është i pamundshëm të kthehet, duke siguruar kështu fuqi puntore falas. Në këtë mënyrë, një familje lidhet brez pas brezi, fëmijët futen në punë për të zëvendësuar prindërit që tashmë janë të moshuar ose të sëmurë.
- Forma më e përhapur e punës skllavëruese realizohet nëpërmjet një marrëveshjeje jolegale ndërmjet prindërve, të cilët, duke qenë në një gjendje të dëshpëruar ekonomike, u japin fëmijët për t'i mbajtur në shkëmbim të punës që kryejnë. Nga ana tjetër, prindërit janë të bindur se fëmijët jetojnë më mirë duke punuar në një familje të pasur se në familjen e tyre.
- Shumë shpesh fëmijët mashtrohen dhe futen në rrugën e tregtisë së shfrytëzimit seksual nëpërmjet prostitucionit dhe pornografisë.
- Tregtia e seksit është një ndër format më të këqija të dhunës ndaj fëmijëve. Fëmijët që i nënshtrohen kësaj dhune, përballojnë një ndër format më të papranueshme të punës, pasi dhunohen rëndë fizikisht, emocionalisht, psikologjikisht me pasoja që zgjasin gjatë gjithë jetës dhe që në shumë raste vënë në rrezik jetën dhe rritjen e tyre.
- Fëmijët që përdoren në sektorin e shfrytëzimit seksual, ballafaqohen me rrezikun e shtatëzanisë së parakohshme, si dhe HIV/AIDS. Studimet e kryera dhe dëshmitë e fëmijëve tregojnë se ata përjetojnë një traumë shumë të fuqishme dhe të thellë që i pengon të riintegrohen në jetën normale. Shumë prej këtyre fëmijëve vdesin para se të arrijnë moshën e të rriturit.
- Sipas të dhënave, është në rritje shfrytëzimi seksual i djemve.
- Vëndet në tranzicion (të Evropës Qendrore dhe Lindore) po përjetojnë një rritje shumë të madhe të trafikut të grave dhe vajzave.
- Zgjatja edhe me një vit e arsimit të detyruar ndikon shumë në ngushtimin e rrezikut të punësimit të vajzave dhe djemve.

## Shtesa 2

### Shkaqet dhe pasojat e punës së fëmijëve

#### Nuk kanë akses në arsim

Përveç punës, ka dhe arsye të tjera pse fëmijët nuk shkojnë në shkollë. Në shumë vende të botës arsimi fillor nuk është falas dhe nuk është i siguar për të gjithë fëmijët. Në vendet ku u sigurohet arsimi, jo gjithmonë cilësia e tij është e mirë. Në rastet ku arsimi është shumë i kushtueshëm apo kur prindërit nuk e quajnë të nevojshëm për fëmijët e tyre, parapëlqehet më shumë t'i punësojnë fëmijët se të ndjekin shkollën. Kjo është një dukuri mbizotëruese në vendet e varfra, kryesisht në ato shtesa shoqërore që janë të diskriminuara dhe ekonomikisht të pafavorizuar, për rrjedhojë bëhen pre e shfrytëzimit në punë.

#### Varfëria

Një ndër faktorët kryesorë të punës së fëmijëve është varfëria. Familjet e varfra kanë nevojë për para dhe në këto kushte, fëmijët ndihmojnë duke sjell nëpërmjet punës së tyre 20-25% të të ardhurave familjare (1/4 e të ardhurave). Meqë në familjet e varfra të ardhurat përdoren kryesisht vetëm për ushqim, është e qartë se të ardhurat e fëmijëve përdoren vetëm për të mbijetuar. Megjithatë, nuk është e saktë të thuash se puna e fëmijëve vjen vetëm si rrjedhojë e varfërisë. Realiteti është shumë i ndërlikuar. Në shumë prej familjeve të varfra, të paktën një fëmijë ndjek shkollën.. Nga ana tjetër, ndërsa në disa vende të botës puna e fëmijëve është shumë e përhapur, në vende të tjera me të njëjtin nivel ekonomik nuk është e tillë. P.sh., në shtetin Kerala, në Indi, edhe pse është një vend i varfër, atje është mënjanuar puna e fëmijëve. Vende me të njëjtin nivel ekonomik kanë shkallë të ndryshme, shumë të larta ose shumë të ulta, të punësimit të fëmijëve.

#### Tradita

Në shumë vende është traditë që fëmijët të ndjekin gjurmët e prindërve. Nëse familja punon në një sektor të rrezikshëm, siç është regjia e lëkurëve, gjasat janë që dhe fëmijët të bëjnë të njëjtën punë. Në disa sektorë ku puna paguhet me akord, shpesh fëmijët përfshihen për të ndihmuar anëtarët e familjes.

## Kushte veçanërisht të dëmshme

Puna e rrezikshme e fëmijëve është më e përhapur në ato familje që kanë kushte shumë të këqija ekonomike dhe që nuk mund të përballojnë sëmundjet e ndryshme ose që nuk përballojnë jetesën në rastet kur një nga bashkëshortët braktis familjen ose prindërit ndahen. Në shumë raste, këto familje hyjnë në borxhe që jo rrallë përbëjnë dhe shkakun kryesor të punësimit të fëmijëve si shërbyes. Pra bëhet fjalë për një shitje të vërtetë të punës së fëmijës që të paguajnë borxhin.

## Kërkesa për punën e fëmijëve

Punëdhënësit parapëlqejnë të marrin në punë fëmijë, pasi i paguajnë me pak se të rriturit dhe janë fuqi punëtore e nënshtruar që nuk përpiqen të organizohen për të kërkuar mbrojtje dhe mbështetje. Zgjidhja e problemit mund të bëhet duke vënë në shenjestër ata që përfitojnë nga shfrytëzimi i punës së fëmijëve për t'u dhënë fund praktikave të tilla dhe për të ndihmuar dhe për të mbështetur fëmijët dhe familjet e tyre.

Studimet e kryera për të përcaktuar shkaqet e punës së fëmijëve synojnë të përqendrohen në ofertën e punës, pasi është një opinion i përgjithshëm që shkak është varfëria. Por duhet marrë parasysh dhe oferta për punën e fëmijëve, pra pse punëdhënësit kërkojnë fëmijë. Shpjegimi më i zakonshëm që jepet, është kostoja e ulët dhe aftësitë e papërsëritshme të fëmijëve, e famshmja "gishtat e shkathët". Të dyja shpjegimet janë të pabazuara sipas studimeve të kryera nga Organizata Nderkombëtare e Punës (ILO).

Studimet në terren të ILO-s kanë arritur në përfundimin se çështja "e gishtave të shkathët" është e pabazuar për shumë sektorë të rrezikshëm ku punojnë fëmijët, përfshirë këtu dhe endjen e qylymave, përpunimin e qelqit, nxjerrjen e ardezës (lloj guri), prodhimin e bravave dhe shkëlqimin e gurëve të çmuar. Në të gjithë këta sektorë, fëmijët punojnë së bashku me të rriturit. Në pjesën më të madhe të rasteve, fëmijët kryejnë punë të pakualifikuar. Një studim i kryer në sektorin e endjeve të qylymave në 2000 puntorë, ka treguar se fëmijët nuk janë më të aftë se të rriturit. Madje, endja e tapeteve më të çmuar bëhet nga të rriturit. Pra, nëse "aftësia e gishtave" të fëmijëve nuk është kaq e rëndësishme në një lloj pune që kërkon shumë aftësi, është e vështirë të pranosh se kjo është e pranueshme për sektorë të tjerë pune.

Edhe argumenti "i koston së ulët" nuk është i bazuar. Është e vërtetë se në pjesën më të madhe të rasteve, puna e fëmijëve paguhet më pak se puna e të rriturve, por ndryshimi i koston nuk është aq i dukshme dhe përcaktuese siç thuhet. ILO, në studimet e kryera, ka vërejtur se në çmimin përfundimtar të prodhimit të byzylykëve dhe tapeteve, përfitimi nga puna e fëmijëve është 5% për byzylykët dhe dhe 5-10% për tapetet. Në të tilla

kushte, lind pyetja: “Pse punësohen fëmijë në këta sektorë?”. Përgjigjja duhet të kërkohej tek ata që fitojnë nga puna e fëmijëve.

Nga sa përmendëm, del se fëmijët nuk janë ekonomikisht të nevojshëm në një sektor kaq konkurrues, siç është tregu i tapeteve. Nga ana tjetër, studimet e kryera kanë hedhur dyshime të forta rreth asaj që sektorë të caktuar mund t'i bëjnë ballë konkurrencës falë përdorimit të punës së fëmijëve. Megjithatë, në sistemin e ekonomisë së tregut global, mënjanimi i punës së fëmijëve në një vend, mund të bëjë të mundur transferimin e kësaj veprimtarie në një vend tjetër ku ekziston puna e fëmijëve. Kjo është arsyeja që për të luftuar dukurinë e punës së fëmijëve, duhet të përfshihen të gjithë prodhuesit e një sektori.

Në bazë të këtyre të dhënave, del se shkaqet kryesore të punësimit të fëmijëve nuk duket se janë të natyrës ekonomike. Në të vërtetë, fëmijët janë lehtësisht të manaxhueshëm, pasi nuk janë të ndërgjegjshëm për të drejtat e tyre, janë më pak kundërshtues, janë më të bindur, më të besueshëm dhe mungojnë më pak në punë.

Gjatë diskutimit në grup, mundohuni të trajtoni të gjitha këto çështje dhe kërkojuni pjestarëve të grupit të shprehin mendimet, vlerësimet dhe ndjenjat e tyre në lidhje me to.

## **Pasojat e punës së fëmijëve**

Gjendja fizike dhe psikologjike e fëmijëve është e ndryshme nga ajo e të rriturve. Prandaj punësimi i tyre në sektorë që mbartin rreziqe të caktuara, i bën më të ndjeshëm ndaj pasojave negative të punës, krahasuar me të rriturit. Meqë zhvillimi i tyre mendor nuk është ende në shkallën e pjekurisë, ata nuk janë të ndërgjegjshëm për rreziqet e mundshme që ka në vendet e punës.

Pasojat negative të kushteve të punës për shëndetin e fëmijëve mund të jenë shkatërrues. Kështu, p.sh., mbajtja e peshave të rënda apo pozicionimi gjatë punës në qëndrime jo të natyrshme mund të shkaktojnë deformime të pakthyeshme në fizikun e një fëmije që është në rritje. Gjithashtu, është vërtetuar se në krahasim me të rriturit, ekspozimi ndaj substancave kimike dhe rrezatimeve, ndikon negativisht më shpejt në përkeqësimin e shëndetit të fëmijëve dhe janë më pak të qëndrueshëm ndaj sëmundjeve.

Gjithashtu, fëmijët janë më të ndjeshëm se të rriturit ndaj dhunës fizike, seksuale dhe psikologjike; jeta dhe puna e fëmijëve në një mjedis shtypës dhe shfrytëzues sjell pasoja shumë të rënda në zhvillimin psikologjik. Kjo është veçanërisht e dukshme te fëmijët e vegjël dhe më shumë tek vajzat. Zakonisht vajzat:

- Fillojnë të punojnë para djemve;
- Paguhen më pak se djemtë për të njëjtën punë;
- Punësohen në sektorë që kanë kohëzgjatje të madhe pune dhe paguhen pak;
- Punojnë në punë që është vështirë t'i konstatosh dhe për këtë arsye janë më shumë të ekspozuara ndaj shfrytëzimit dhe dhunës;
- Punësohen në sektorë me rrezikshmëri të lartë përsa i përket shëndetit, sigurisë dhe mirëqenies.
- Përrjashtohen nga arsimimi, por dhe në rastet kur ndjekin shkollën, kanë një ngarkesë të trefishtë: shkollë, punë shtëpie dhe punësim.

Ekspertët që përcaktojnë parametrat e higjienës dhe të shëndetit të vendeve të punës, vlerësojnë kushtet e punës në bujqësi, ku punësohet numri më i madh i fëmijëve, nga më të rrezikshmet. Moti i keq, punë shumë të rënda për fëmijën që është fizikisht i parritur dhe aksidentet në punë, si: plagosjet me vleglat e punës etj., janë disa nga kushtet ndaj të cilave ekspozohen fëmijët. Përdorimi i teknologjisë së re gjatë mbjelljeve sjell dhe rreziqe të reja, si: afërsia me makinat, përdorimi i substancave kimike etj. Shumë fëmijë aksidentohen duke zbritur nga traktori apo shtypen nga makinat e mëdha me rimorkio që përshkojnë fushat pët të ngarkuar prodhimin.

Në shumë vende vështirësive dhe rreziqeve të punës i shtohet edhe mungesa e strukturave të kujdesit për shëndetin, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve, si dhe ushqyerja jo e përshtatshme. Legjislacioni në bujqësi është shumë i kufizuar. Në shumë vende të botës qendrat ku punojnë fëmijët, janë të përjashtuara nga normat e punës të rregulluara me ligj, pasi trajtohen si ndërmarrje të vogla familjare. Edhe në rastet kur ka një mbrojtje ligjore, zbatimi i saj është shumë i vështirë për shkak të shtrirjes së gjerë gjeografike të sektorit të bujqësisë.

### **Pse duhet mënjanuar plotësisht puna e fëmijëve?**

- Puna e fëmijëve është një dëm dhe rrezik për ta, si dhe dhunon të drejtat e tyre ndërkombëtare dhe kombëtare.
- Puna e fëmijëve është një veprimtari që përbën rrezik dhe dëm për ta nga pikëpamja e zhvillimit të tyre fizik, shoqëror dhe moral.
- Puna i pengon fëmijët të shkojnë në shkollë ose i ngarkon ata dyfish duke punuar dhe duke ndjekur shkollën.
- Puna e fëmijëve mund të jetë edhe një formë e skllavërisë së tyre dhe e largimit nga familja.

- Puna e fëmijëve i dënon ata dhe familjet e tyre në një spirale varfërie dhe privimesh.
- Fëmijët rrezikojnë më shumë se të rriturit në vendet e punës, duke qenë se janë më të dobët fizikisht dhe të papjekur mendërisht.

Sondazhet dhe statistikat e zhvilluara tregojnë se një përqindje shumë e lartë e fëmijëve aksidentohen edhe sëmuren në vendet e tyre të punës. Disa prej tyre nga ky shkak nuk do të mundin kurrë më të punojnë.

Në sektorin e bujqësisë ku përdoren makina dhe vegla të ndryshme, propabilitetit për aksidente në vendin e punës, është më i lartë. Bujqësia, minierat dhe sektori i ndërtimeve janë me rrezikshmërinë më të lartë për fëmijët që punojnë

## Shtesa 3

### Shembuj të vendeve të punës që mbartin rrezik

Puna	Punët kryesore	Rreziqet	Dëmet e mundshme
<b>MINIERA</b>	Gërmime nëntokë dhe transportimi i peshave shumë të rënda	Ekspozimi ndaj pluhurit, gazit, kriprave, niveleve ekstreme të lagështisë dhe të temperaturave, pozicione të papërshtatshme pune (të palosur, të gjunjëzuar, të shtrirë), rrëshqitje e terrenit.	Sëmundje të rrugëve të frymëmarrjes që degjenerojnë në silokozë, sëmundje të mushkërive, sëmundje të kockave dhe muskujve, thyerje dhe rrezik për jetën nga rrëshqitjet e dherave.
<b>PRODHIMI I TULLAVE</b>	Përpunimi i argjilës (nxjerrja, thyerja, bluarja, trazimi dhe ndarja)	Ekspozimi ndaj substancave të silikatit, plumbit, gazit karbonik. Transportimi i peshave të rënda, djegia në furra, përdorimi i veglave që mund të provokojnë aksidente.	Deformim i muskujve, i kockave, plagë dhe dëmtime të tjera.
<b>BUJOËSIA</b>	Përdorimi i makinerive, i substancave kimike. Mbledhja dhe transportimi i prodhimit	Makineri dhe vegla të rrezikshme, substanca të rrezikshme (insekticidet, pesticidet, herbicidet), pesha të rënda, temperatura ekstreme.	Helmim nga substancat kimike (kronike dhe akute), plagë të ndryshme si pasojë e aksidenteve dhe sëmundje.
<b>ENDJA E QYLYMAVE</b>	Endja me dorë e qylymave në avlëmend.	Thithja e pluhurit të leshit që mbart mikrobe të kërpudhave, pozicioni i papërshtatshëm i trupit (të kruspullosur), mungesë drite, mungesë e ajrimit, agjentë kimikë të rrezikshëm.	Sëmundje të rrugëve të frymëmarrjes, të muskujve dhe kockave, sforcimi i të parit, defekte të të parit në moshë shumë të re, helmimi nga substanca kimike, shtimi i sëmundjeve të ndryshme.
<b>NDËRTIMI</b>	Gërmim dheu, transportimi i peshave të rënda, thyerje gurësh dhe shkëmbinjsh, sitja e rërës apo çimentos, përpunimi i metaleve.	Rënia e sendeve të rënda, sende të mprehta ku mund të pengohesh dhe të pritesh, ekspozimi ndaj pluhurave, temperaturave të larta, zhurmave, si dhe ngritja e peshave të rënda.	Dëmtimi i të dëgjuarit nga zhurmat e mëdha, nga vibrimet e fuqishme, dëmtimi i përhershëm dhe humbja e aftësisë për të punuar nga aksidente të rënda, siç është rënia nga skelat.



Puna	Punët kryesore	Rreziqet	Dëmet e mundshme
<b>REGJIA</b>	Regjia e lëkurës, kullimi e pastrimi.	Ekspozimi ndaj agjentëve kimikë gërryes, si dhe helmimi bakteriologjik nga lëkurët.	Sëmundje të ndryshme të lëkurës.
<b>PESHKIMI NË THELLËSI</b>	Zhytje në thellësi deri në 60 m për të vendosur rrjetat në koralet.	Ekspozimi ndaj presionit të lartë atmosferik, sulme të peshqve mishëngrënës të helmatisur, kushte shumë të rënda.	Çarja e timpanit të veshit, humbja e jetës apo aksidente të rënda, sëmundje gastro-intestinale, si dhe sëmundje të tjera ngjitëse
<b>PËRPUNIMI I XHAMIT</b>	Përpunimi i xhamit të shkrirë dhe transportimi i tij.	Stres termik dhe rreze të dëmshme, pluhur silici, kontakt me ciflat e xhamit.	Trauma nga aksidentet, dëmtime të syve dhe plagë, sëmundje të frymëmarrjes, djegie dhe prerje të rrezikshme.
<b>PRODHIMI I SHKREPSEVE DHE FISHEKZJARREVE</b>	Përzierje të substancave kimike djegëse ( me çlirim avujsh), prodhim të shkrepseve dhe mbushje e kartuçave të fishekzjarreve me barut.	Ekspozimi ndaj substancave të dëmshme kimike, djegia dhe aksidentime nga shpërthimi.	Helmimi nga substanca të dëmshme, sëmundje të frymëmarrjes, djegie, dëmtime të rënda, madje edhe me vdekje si pasojë e shpërthimeve.
<b>MBLEDHJA E PLEHËRAVE</b>	Punë poshtëruese dhe e pisët; mbledhja e plehërave, madje dhe shumë të rrezikshme, si: mbetjet e spitaleve, në të shumtën e rasteve pa dorashka mbrojtëse.	Plagë si pasojë e prerjes me xham, metal, ekspozimi ndaj substancave të dëmshme, thithja e erërave të këqija, si dhe kontakti me lloje të ndryshme parazitësh, mundësia e ngrënies së produkteve ushqimore të plehërave.	Vdekje nga tetanozi, helmim nga substanca kimike, rrezikohen të jenë protatorë, pra të infektuar nga sëmundje ngjitëse, djegie nga gazi metan
<b>PËRPUNIMI I GURIT ARDES</b>	Ngritje e peshave të rënda, prodhimi i lapsave dhe dërrasave.	Dëme si pasojë e transportimit të peshave të rënda, ekspozimi ndaj pluhurit të silicit.	Sëmundje të muskujve dhe kockave, sëmundje të mushkrive dhe paaftësi e parakohshme.

## Shtesa 4

### Puna e fëmijëve në Shqipëri

Kalimi i Shqipërisë në ekonominë e tregut ka sjellë si pasojë lindjen e ekonomisë informale (tregun gri), në të cilin puna e fëmijës është mjaft e përhapur. Prania e të gjithë faktorëve socialekonomikë e shpjegojnë këtë situatë, si: varfëria, mungesa e shkollave dhe e mësuesve në zona të caktuara, ndarja e familjes, mungesa e informacionit për rëndësinë e shkollës, diskriminimi kundër etnive minoritare etj. Faktikisht, puna është kuptuar si e mirë për ndërtimin e personalitetit dhe të aftësive të zhvillimit të fëmijëve, pavarësisht rreziqeve fizike dhe morale ndaj të cilave fëmija është i ekspozuar. Fëmijët, gjithashtu, presin të mësojnë profesionet tradicionale të prindërve të tyre. Kjo ndikon në rritjen e punës së fëmijëve. Duke u bazuar në të dhënat e Institutit të Statistikave në Shqipëri, 32% e fëmijëve ndërmjet grup-moshave 6 dhe 17 vjeç janë duke punuar. Ndërsa Ministria e Rendit e bën bën të qartë se ndërmjet viteve 1992-2002, janë trafikuar 4000 fëmijë shqiptarë. Format më të këqija të punës së fëmijëve në Shqipëri janë: puna në rrugë, trafikimi për punë dhe shfytëzim seksual, veprimtari të jashtëligjshme, punë të rrezikshme në sektorin formal dhe bujqësor etj.

**Puna e fëmijëve në rrugë.** Duke u bazuar në metodologjinë e vlerësimit të shpejtë të IPEC-ut, në një kampion grupi prej 298 fëmijësh që punojnë në rrugë, të vëzhguar në vitin 2002 në tri qytete: Tiranë, Shkodër dhe Vlorë, pjesa më e madhe e tyre janë djem (81,5%) që kanë braktisur shkollën dhe janë të grup-moshave 12-17 vjeç. Arsyeja kryesore që fëmijët punojnë në rrugë, është varfëria. Arsyet e tjera janë: a) 10,2% familjare (divorci, vdekja e prindërve, problemet shëndetësore të prindërve etj); b) 9,1% arsimore, si: vijueshmërisë së ulët të shkollës (mungesa e shkollës pranë vendbanimit, përjashtimi nga shkolla, ecuria në mësim, mospëlqimi i shkollës). Sipas mësuesve të intervistuar, shumë fëmijë e braktisin shkollën pasi kanë mbetur disa herë ose kur ata dhe prindërit e tyre e kanë kuptuar se rezultatet shkollore nuk e përligjin kohën e shpenzuar në shkollë. Fëmijët punojnë si shitës, lypës, mbledhës plehrash, lustrues këpucësh dhe hamej. Jeta e fëmijës që punon, është e lidhur me probleme të shumta, si: shëndeti, morali, socializimi dhe zhvillimi, në përgjithësi. Fëmijët që punojnë në rrugë, janë gjithashtu të prekur ndaj përfshirjes në forma të rrezikshme të punës, si: trafikimi, veprimtaritë e jashtëligjshme dhe prostitucioni.

**Trafikimi i fëmijëve.** Modelet e trafikimit në Shqipëri janë: kalimi nga Shqipëria në Itali dhe Greqi (trafikimi jashtë vendit), kalimi nga zonat rurale në zonat urbane ose nga zonat e varfra në zonat me mirëqenie më të lartë (trafikimi i brendshëm). Sipas metodologjisë së vlerësimit të shpejtë të trafikimit të fëmijëve të vitit 2003, e realizuar nga ILO-IPEC në Tiranë, Korçë, Elbasan dhe Vlorë, pjesa më e madhe e fëmijëve të trafikuar nga Shqipëria për në Greqi dhe Itali janë djem që u përkasin grup-moshave 11-16 vjeç, të cilët u përkasin familjeve me probleme. Shumë fëmijë janë shfrytëzuar për të punuar në rrugë, për të lypur, për të shitur dhe për veprimtari të tjera të jashtëligjshme (vjedhje dhe drogë). Ata punojnë me orë të zgjatura në kushte që janë

të dëmshme për shëndetin e tyre. Ata janë të privuar nga mundësitë për arsimim dhe në rrezik ndaj abuzimeve fizike, seksuale dhe emocionale. Trafikim i fëmijëve jashtë Shqipërisë duket se është zvogëluar këto dy vitet e fundit nga kontrolli i lartë në kufi dhe parandalimet në punën brenda vendit. Trafikimi i fëmijëve duket të jetë më pak i dhunshëm dhe të përqendrohet më shumë ndaj familjeve dhe fëmijëve më të prekshëm (si është përshkruar në protokollin e Palermos). Ritrafikimi dhe përhapja e trafikimit të brendshëm duket se po rritet.

**Fëmijët e përfshirë në veprimtari të jashtëligjshme.** Një numër i madh i fëmijëve dhe të rinjve janë në konflikt me ligjin (14-25 vjeç). Sipas vlerësimit të Ministrisë së Rendit, 43 % e të dënuarve në Shqipëri në vitin 2003 qenë të rinj. Disa vijnë nga familje me probleme që kanë mundësi të pakta për të patur punë të ligjshme ose fëmijët me një nivel të ulët arsimor (fëmijët që kanë braktisur shkollën, duket se janë më shumë të përfshirë në krime). Krimet më të shpeshta të të rinjve në Shqipëri janë: vjedhja, vrasja dhe ngacmimi seksual; krime të lidhura me shitjen, shpërndarjen dhe përdorimin e drogës. Faktorët që lidhen me sjelljen kriminale të të rinjve janë: mjedisi familjar (divorci, dhuna dhe familjet me një prind); mungesa e kapitalit social të të rinjve të ardhur nga zonat rurale në ato urbane, mungesa e orientimit të aftësive, gjakmarrja në pjesën veriore të Shqipërisë, trafikikimi i paligjshëm i qenieve njerëzore ku fëmijët janë viktimat dhe të përfshirë në këto krime. Përgjegjësia e kriminalitetit të të rinjve është karakterizuar nga korrupsioni, paaftësia e sistemit gjyqësor, si dhe nga mungesa e një metodologji ndëshkuese në përpjesëtim të zhdrejtë me nismat mbështetëse.

**Fëmijët që punojnë në sektorët formal.** Një numër i ndjeshëm fëmijësh punojnë në vende shumë të rrezikshme dhe në kushte të vështira në sektorë të tillë: ndërtim, industri minierash, fabrika këpucëve dhe veshjesh. Ata janë të punësuar si punëtorë të përhershëm, sezonalë dhe ditorë.

**Fëmijët që punojnë në bujqësi.** Bujqësia është sektori kryesor në Shqipëri, i cili përfaqësoi 50% të GDP në vitin 2002. Ky është burimi kryesor për gjysmën e popullsisë në Shqipëri. Puna e fëmijëve në këtë sektor ka qenë gjithmonë e përhapur në Shqipëri. Fëmijët e ardhur nga zonat rurale, në veçanti vajzat, synojnë të fillojnë punë që në moshën 5, 6 ose 7-vjeçare. Shfrytëzimi i punës së fëmijëve në kushte të rrezikshme në bujqësi shpjegohet me faktin se pjesëtarët e rritur të familjes kanë ikur jashtë shtetit ose në qytetet e mëdha dhe janë zëvendësuar nga fëmijët e tyre. Pjesa më e madhe e kësaj pune është e padukshme ose e panjohur dhe është e ndarë në "punë të vogla". Përveç kësaj, "familja bujqësore", si baza për organizimin ekonomik, e bën të vështirë identifikimin e fëmijëve që të shfrytëzohen në këtë mënyrë. Shfrytëzimi i fëmijës në bujqësi mund të interpretohet si "solidaritet familjar", madje edhe kur është i ekspozuar ndaj pesticideve dhe formave të rrezikshme të punës ose punë që kërkojnë orar të zgjatur.

# Shënime

A series of horizontal dotted lines for writing notes.